

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Doganore Fier me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor” dhe për auditimin e insitucionit për vitin 2010 dhe 2011. Masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.123, datë 06/08/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 424/9, datë 06/08/2012 dërguar Z. Roland Haskaj, Kryetar i Degës Doganore Fier, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Autoriteti doganor kompetent të analizojë me të gjithë stafin, Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur shkeljet e konstatuara, ndërkohë të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të dërguara bashkëlidhur këtij raporti.

Menjëherë

2. Të merren masa të plota ligjore për zbatimin e detyrave të rekomanduara në kontrollin e mëparshëm, për një subjekt privat të dërguar me shkresën nr. 12/5 datë 28.06.2010, por që nuk është zbatuar.

Menjëherë

3. Të merren masa të menjëhershme për të gjitha praktikat doganore që rezultojnë me diferenca në peshë, të saktësohen me dokumentacion përkatës dhe për shkeljet e konstatuara të zbatohen sanksionet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, miratuar me VKM nr. 205, datë 13.03.1999, i ndryshuar.

Vazhdimisht

4. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren të gjitha masat për zbatimin e dispozitave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor në vlerë 121,604,584 lekë ,e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

Vazhdimisht

5. Doganieri i borxhit në bashkëpunim me sektorin e financës të marrin masa dhe të llogarisin kamat vonesat në zbatim të nenit 242- 245 të Kodit Doganor, në bazë të udhëzimit nr.4 datë 04.08.2006 mbi “Zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor”.

Menjëherë

B. Masa Zhdëmtimi

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe kontrollin aposterior të saktësohen dhe të kërkohen në rrugë ligjore, të kontabilizohen dhe të arkëtohen detyrimet doganore të rezultuara të pa llogaritura ose të llogaritura më pak, për vitin 2010 në vlerë 520,320 lekë dhe vitin 2011 në vlerë 676,704 lekë, gjithsej 1,197,024 lekë. Subjektet dhe vlerat sipas tabelës nr. 1 dhe 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datë 30.10.2012

2. Të saktësohen dhe të kërkohen në rrugë ligjore, të kontabilizohen dhe të arkëtohen detyrimet doganore për, peshën e pa deklaruar dhe të pajustificuar, me peshën në fakt, në praktika të ndryshme, që variojnë mbi 5 % të peshës së deklaruar, në vlerë 7,012,303 lekë,nga e cila për vitin 2010 në vlerë 2,802,977 lekë dhe për vitin 2011 në vlerë 4,209,326 lekë. Subjektet dhe vlerat sipas tabelës nr. 3 dhe 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datë 30.11.2012

3. Të saktësohen dhe të kërkohen në rrugë ligjore, të kontabilizohen dhe të arkëtohen, detyrimet doganore, për një subjekt privat për proces verbale të mbajtura për kundërvajtje administrative, për mos klasifikim të drejtë të kodit tarifor, bazuar në analizat e laboratorit kimik doganor Tiranë, për vitin 2011 lëndë djegëse dhe gazoil në vlerë 4,030,625 lekë. Subjektet dhe vlerat sipas tabelës nr.5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datë 30.12.2012

4. Të saktësohen dhe të kërkohen në rrugë ligjore, të kontabizohen dhe të arkëtohen detyrimet doganore për regjimet, në vlerë 879,218 lekë, penalitet në vlerë 750,000 lekë dhe detyrim doganor në vlerë 45,660 lekë, nga e cila për vitin 2010 në vlerë 445,660 lekë dhe vitin 2011 në vlerë 350,000 lekë, për mos mbyllje në afat të regjimeve, mos përputhje në kuadratet 31- 38 të DAV, dhe pa llogaritur detyrimin doganor, për import në disa artikuj, të pa përfshirë në autorizim. Vendime administrative për proces verbalet e paraqitura nga doganierët e regjimit për kundërvajtje administrative, për diferenca, ndërmjet importit dhe eksportit në artikullin këmisha, konfeksione rroba plazhi dhe mbulesë për rroba plazhi, më tepër në eksport, paraqitur dhe marrë vendimi, jo sipas kërkesave ligjore, në vlerë 83,558 lekë për një subjekt. Subjektet dhe vlerat sipas tabelës nr. 6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datë 30.10.2012

5. Në Bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të saktësohen dhe të kërkohen në rrugë ligjore, të kontabilizohen dhe të arkëtohen detyrimet doganore, për vendime administrative, që kanë rezultuar të pa bazuara në kërkesat e ligjit, proces verbalet e pa gjykuara, në shumën 6,674,859 lekë. Subjektet dhe vlerat sipas tabelës nr.7 dhe 8 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datë 30.11.2012

C. Masa Disiplinore

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me vendimin nr. 686, datë 02/11/2005 dhe në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara, gjatë auditimit, ti rekomandojë Kryetarit të Doganës Fier që t'i propozojë Komitetit disiplinor ndëshkimin me masën:

1. “Humbjen e së drejtës së shpërblimeve për 1 vit”, dispozita 18.1.4 gërma c, për pesë punonjës, për mos dëbim të procedurave të kodit doganor nenet 256/1/a, 256/4, 261/1, 262/2, 275/1, 287/2/f
2. “Vërejtje me paralajmërim”, dispozita 18.1.4 gërma a, për gjashtë punonjës me detyrë hetues doganor, për për shkelje të nenit 216 dhe 236 të ligjit për “Kodin Doganor” dhe
3. për dy punonjës të cilët nuk janë më pjesë e punonjesve të sistemit doganor nuk u propozuan masa administrative disiplinore

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit z. Din Zenelaj, përgjegjës grupi, z. Hodo Hasani, anëtar, z. Agron Opari, anëtar. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit z. Edvin Stefani, Drejtori i Departamentit z. Aleksandër Lipivani dhe Drejtori i Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.